

**DIREKTIVA NR. 92/85/KEE, “MBI PARAQITJEN E MASAVE PËR TË  
INKURAJUAR PËRMIRËSIMIN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË  
PËR PUNËTORET SHTATZËNA DHE PUNËTORET TË CILAT SAPO  
KANË LINDUR FËMIJË OSE QË JANË ME FËMIJË NË GJË”**

*19 tetor 1992*

Këshilli i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, dhe në veçanti nenin 118a të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit, i hartuar pas këshillimit me Komitetin Këshillimor për Sigurinë, Higjienën dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë,

Në bashkëpunim me Parlamentin Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social,

Ndërkohë që neni 118a i Traktatit përcakton se Këshilli do të miratojë, me anë të direktivave, kërkesat minimale për të inkurajuar përmirësime, sidomos në ambientin e punës, për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve;

Ndërkohë që kjo Direktivë nuk përlligj ndonjë reduktim të nivelit mbrojtës të arritur nga shtetet anëtare, të cilat janë të angazhuara sipas Traktatit, për të nxitur përmirësimin e kushteve në këtë fushë dhe për të harmonizuar kushtet, ndërkohë që ruhen përmirësimet e bëra;

Ndërkohë që, në bazë të kushteve të nenit 118a të Traktatit, direktivat në fjalë janë për të shmangur vendosjen e detyrimeve administrative, financiare dhe ligjore në një mënyrë e cila do të frenonte krijimin dhe zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla e të mesme;

Ndërkohë që, në zbatim të Vendimit 74/325/KEE, i ndryshuar herën e fundit nga Akti i Hyrjes, më datë njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë, Komiteti Këshillimor për Sigurinë, Higjienën dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë është këshilluar nga Komisioni për hartimin e propozimeve në këtë fushë;

Ndërkohë që Karta e Komunitetit për të Drejtat Sociale Themelore të Punëtorëve, miratuar në Këshillin Evropian të Strasburgut, më datë nëntë dhjetor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë, nga Kryetarët e shteteve apo qeverive të njëmbëdhjetë shteteve anëtare, përcakton, në veçanti, në paragrafin 19 se:

“Çdo punëtor duhet të gëzojë kushte të kënaqshme shëndeti dhe sigurie në ambientin e tij të punës. Duhet të merren masat e duhura në mënyrë që të arrihet

harmonizimi i mëtejshëm i kushteve në këtë fushë, ndërkohë që ruhen përmirësimet e bëra;

Ndërkohë që Komisioni, në programin e tij të veprimit për zbatimin e Kartës të Komunitetit për të Drejtat Sociale Themelore të Punëtorëve, ka përfshirë në qëllimet e tij, miratimin nga Këshilli të një Direktive mbi mbrojtjen e grave shtatzëna në punë;

Ndërkohë që neni 15 i Direktivës së Këshillit 89/391/KEE, të dymbëdhjetë qershorit njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë, mbi paraqitjen e masave për të nxitur përmirësimet e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë, parashikon që, në mënyrë të veçantë, grupet me ndjeshmëri të veçantë ndaj rrezikut duhet të mbrohen ndaj rreziqeve që i prek në mënyrë specifike ato;

Ndërkohë që punëtorët shtatzëna, punëtorët të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, duhet të konsiderohen si një grup me rrezik të veçantë në shumë aspekte, dhe duhet të merren masa në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e tyre;

Ndërkohë që mbrojtja e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve shtatzëna, punëtorëve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, nuk duhet t'i trajtojë gratë në mënyrë të pafavorshme në tregun e punës dhe as të cenojë direktivat që kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë për burrat dhe gratë;

Ndërkohë që disa lloje aktivitete mund të përbëjnë rrezik të veçantë, për punëtorët shtatzëna, punëtorët të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, ndaj ekspozimit të agjentëve të rrezikshëm, proceseve apo kushteve të punës; ndërkohë që rreziqe të tilla mund të vlerësohen, dhe rezultati i një vlerësimi të tillë tu komunikohet punëtorëve femra dhe/ose përfaqësuesve të tyre;

Ndërkohë që, më tej, nëse rezultati i këtij vlerësimi zbulon praninë e një rreziku për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve femra, duhet të merren masa për mbrojtjen e këtyre punëtorëve;

Ndërkohë që, punëtorët shtatzëna, punëtorët të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, nuk duhet të përfshihen në aktivitete të cilat janë vlerësuar se paraqesin një rrezik ekspozimi, duke rrezikuar sigurinë dhe shëndetin, ndaj disa agjenteve të dëmshëm apo kushteve të rrezikshme të punës;

Ndërkohë që duhen marrë masa për punëtorët shtatzëna, punëtorët të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, që të mos u kërkohet të punojnë natën, ndërkohë që masa të tilla janë të nevojshme në aspektin e sigurisë dhe shëndetit të tyre;

Ndërkohë që cënueshmëria e punëtorëve shtatzëna, punëtorëve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, e bën të nevojshme që atyre tu jepet leja e shtatzënisë për të paktën katërbëdhjetë javë në vazhdim, e caktuar përpara dhe/ose pas lehonisë, gjë e cila e bën të nevojshme natyrën e detyrueshme të lejes së shtatzënisë për të paktën dy javë, e caktuar para dhe/ose pas lehonisë;

Ndërkohë që rreziku i pushimit nga puna për arsye që lidhen me gjendjen e tyre, mund të ketë efekte të dëmshme në gjendjen fizike dhe mendore të punëtoreve shtatzëna, punëtoreve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji; ndërkohë që duhen marre masa për pushimet nga puna ose ndalimin e tyre;

Ndërkohë që masat për organizimin e punës në lidhje me mbrojtjen e shëndetit të punëtoreve shtatzëna, punëtoreve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, nuk do të kenë efekt nëse nuk shoqërohen me ruajtjen e të drejtave të lidhura me kontratën e punësimit, përfshirë vazhdimin e pagesës dhe/ose të drejtën për një ndihmë financiare të mjaftueshme;

Ndërkohë që, për më tepër, masat në lidhje me lejen e shtatzënisë nuk do të shërbejnë, gjithashtu, nëse nuk shoqërohen me ruajtjen e të drejtave të lidhura me kontratën e punësimit dhe/ose të drejtën për një ndihmë financiare të mjaftueshme;

Ndërkohë që koncepti i një ndihmë financiare të mjaftueshme në rastin e lejes së shtatzënisë, duhet të konsiderohet si një pikë reference teknike, më qëllim caktimin e nivelit minimal të mbrojtjes dhe nuk duhet, në asnjë rrethanë, të interpretohet si analogji shtatzënia me sëmundjen;

Ka miratuar këtë Direktivë

## **PJESA I QËLLIMI DHE PERKUFIZIME**

### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj Direktive, e cila është Direktiva e dhjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE, është të zbatojë masat për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji.

2. Dispozitat e Direktivës 89/391/KEE, përveç nenit 2 (2) të saj, do të zbatohen plotësisht në të gjithë sferën e mbuluar nga paragrafi 1, pa cenuar ndonjë dispozitë më rigorozë dhe /ose më specifike të përfshirë në këtë Direktivë.

3. Kjo Direktivë mund të mos ketë efektin e uljes të nivelit të mbrojtjes akorduar punëtoreve shtatzëna, punëtoreve të cilat sapo kanë lindur fëmijë ose që janë me fëmijë në gji, krahasuar me situatën në të cilën ndodhet çdo shtet anëtar në ditën kur u miratua kjo Direktivë.

### **Neni 2 Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj Direktive:

a. “punëtore shtatzënë” nënkupton një punëtore shtatzënë e cila informon punëdhënësin e saj mbi gjendjen e saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe/ose praktikën kombëtare.

b. “punëtore e cila sapo ka lindur” nënkupton një punëtore e cila sapo ka lindur, brenda kuptimit të legjislacionit kombëtar dhe/ose praktikës kombëtare, dhe që informon punëdhënësin e saj mbi gjendjen e saj, në përputhje me atë legjislacion dhe/ose praktikë.

c. “punëtore me fëmijë në gji” nënkupton një punëtore që është me fëmijë në gji, brenda kuptimit të legjislacionit kombëtar dhe/ose praktikës kombëtare, dhe që informon punëdhënësin e saj për gjendjen e saj, në përputhje me atë legjislacion dhe/ose praktikë.

## **PJESA II DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 3 Udhëzime**

1. Komisioni, në këshillim me shtetet anëtare dhe i ndihmuar nga Komiteti Këshillimor mbi Sigurinë, Higjienën dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë, do të hartojë udhëzime mbi vlerësimin e agjentëve kimikë, fizikë dhe biologjikë dhe të proceseve industriale të konsideruara si të rrezikshme për sigurinë apo shëndetin e punëtoreve, brenda kuptimit të nenin 2.

Udhëzimet e referuara në nën paragrafin e parë do të mbulojnë, gjithashtu, lëvizjet dhe lodhjen fizike dhe mendore si dhe lloje të tjera të stresit fizik dhe mendor që lidhen me punën e kryer nga punëtorët brenda kuptimit të nenin 2.

2. Qëllimi i udhëzimeve të referuar në paragrafin 1, shërben si bazë për vlerësimin e referuar në nenin 4 (1).

Në fund, shtetet anëtare do t'i sjellin këto udhëzime në vëmendjen e të gjithë punëtorëve dhe tek të gjitha punëtorët femra dhe/ose përfaqësuesve të tyre në shtetet përkatëse anëtare.

### **Neni 4 Vlerësimi dhe informimi**

1. Për të gjitha aktivitetet që besohen se përbëjnë një rrezik të caktuar ekspozimi ndaj agjentëve, proceseve ose kushteve të punës për të cilat një listë e pasur është dhënë në Shtojcën I, punëdhënësi do të vlerësojë natyrën, shkallën dhe kohëzgjatjen e ekspozimit, në një sipërmarrje dhe/ose ndërmarrje në fjalë, të punëtorëve brenda kuptimit

te nenit 2, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të shërbimeve mbrojtëse dhe parandaluese të referuara në nenin 7 të Direktivës 89/391/EEC, me qëllim:

- vlerësimin e çdo rreziku të sigurisë apo shëndetit dhe të çdo efekti të mundshëm mbi shtatzëninë ose ushqimin me gji të fëmijës nga punëtorët, brenda kuptimit të nenit 2,
- vendosjen për masat që duhen marrë.

2. Pa cenuar nenin 10 të Direktivës 89/391/KEE, punëtorët brenda kuptimit të referuar në nenin 2 dhe punëtorët me mundësinë për të qenë në një nga situatat e referuara në nenin 2, në një sipërmarrje dhe/ose ndërmarrje në fjalë dhe/ose përfaqësuesit e tyre do të informohen mbi rezultatet e vlerësimit të referuar në paragrafin 1, dhe mbi të gjitha masat e marra në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë.

## **Neni 5**

### **Veprime përtej rezultateve të vlerësimit**

1. Pa cenuar nenin 6 të Direktivës 89/391/KEE, nëse rezultatet e vlerësimit të referuar në nenin 4(1), zbulojnë një rrezik për sigurinë, shëndetin apo një efekt, brenda kuptimit të nenit 2, mbi shtatzëninë apo ushqimin e fëmijës me gji të një punëtores, punëdhënësi do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që, duke rregulluar përkohësisht kushtet e punës dhe/ose oraret e punës të punëtores në fjalë, ekspozimi i kësaj punëtores ndaj këtyre rreziqeve të eliminohet.

2. Nëse rregullimi i kushteve të saj të punës dhe/ose të orareve të punës nuk është teknikisht dhe/ose objektivisht i mundshëm, ose nuk mund të kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, për shkaqe faktike, punëdhënësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për lëvizjen e punëtores në fjalë në një punë tjetër.

3. Nëse lëvizja e saj në një punë tjetër nuk është teknikisht dhe/ose objektivisht e mundshme ose nuk mund të kërkohet, në mënyrë të arsyeshme, për shkaqe faktike, punëtores në fjalë do t'i jepet leja, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe/ose praktikën kombëtare, për të gjithë periudhën e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë ose shëndetit të saj.

4. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen, me ndryshimet e nevojshme, në rastin kur një punëtores që kryen një aktivitet i cili është i ndaluar sipas nenit 6, mbetet shtatzënë ose nis të ushqejë fëmijën me gji dhe njofton punëdhënësin e saj për këtë.

## **Neni 6**

### **Rastet në të cilat ekspozimi është i ndaluar**

Përveç dispozitave të përgjithshme që lidhen me mbrojtjen e punëtorëve, në veçanti të atyre që lidhen me vlerësimet kufizuese për ekspozimin profesional:

1. punëtorët shtatzënë, sipas kuptimit të nenin 2(a), nuk mund të jenë në asnjë rrethanë të detyruara të ushtrojnë detyrat për të cilat vlerësimi ka zbuluar një rrezik ekspozimi, të cilat mund të dëmtojnë sigurinë dhe shëndetin, ndaj agjentëve dhe kushteve të punës të listuar në Shtojcën II, Pjesa A.

2. punëtorët që ushqejnë fëmijët me gji, sipas kuptimit të nenin 2(c), nuk mund të jenë në asnjë rrethanë të detyruara të ushtrojnë detyrat për të cilat vlerësimi ka zbuluar një rrezik ekspozimi, të cilat mund të dëmtojnë sigurinë dhe shëndetin, ndaj agjentëve dhe kushteve të punës të listuar në Shtojcën II, Pjesa B.

### **Neni 7**

#### **Puna gjatë natës**

1. Shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar se punëtorët, e referuara në nenin 2, nuk janë të detyruara të kryejnë punën e natës gjatë shtatzënisë dhe për një periudhë vijuese pas lindjes së fëmijës, e cila do të përcaktohet nga autoriteti kombëtar kompetent për sigurinë dhe shëndetin, me anë të paraqitjes, në përputhje me procedurat e vendosura nga shtetet anëtare, të një certifikate mjekësore se kjo masë është e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin e punëtore në fjalë.

2. Masat e referuara në paragrafin 1 duhet, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare, të lejojnë mundësinë e:

a. transferimit për të punuar ditën; ose

b. largimin me leje nga puna ose zgjatjen e lejes së lindjes kur ky transferim nuk është teknikisht dhe /ose objektivisht i mundshëm ose nuk mund të kërkohet mbi bazat vërtet të arsyeshme.

### **Neni 8**

#### **Leja e lindjes**

1. Shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që punëtorët, në kuptimin e nenit 2, kanë të drejtën e një periudhe të vazhdueshme të lejes së lindjes prej të paktën katërmbëdhjetë javësh, e caktuar përpara dhe/ose pas lehonisë, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare.

2. Leja e lindjes, e parashikuar në paragrafin 1, duhet të përfshijë një leje të detyrueshme lindjeje prej të paktën dy javë, e caktuar përpara dhe/ose pas lehonisë, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare.

### **Neni 9**

#### **Leja për vizitat mjekësore gjatë shtatzënisë**

Shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që punëtorët shtatzëna, në kuptimin e nenit 2 (a), kanë të drejtën e lejes, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare, pa humbur pagesën, në mënyrë që të mund të kryejnë vizitat mjekësore gjatë shtatzënisë, në rast se këto vizita duhet të kryhen gjatë orëve të punës.

### **Neni 10** **Ndalimi i pushimit nga puna**

Me qëllim për të garantuar punëtorëve, brenda kuptimit të nenit 2, ushtrimin e të drejtave për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së tyre, sikurse njihen nga ky nen, do të mundësohet që:

1. Shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për ndalimin e pushimit nga puna të punëtorëve, brenda kuptimit të nenit 2, gjatë periudhës nga fillimi i shtatzënisë deri në fund të lejes së tyre të lindje referuar në nenin 8 (1), përfshirë këtu edhe rastet përjashtimore që nuk lidhen me gjendjen e tyre, për të cilën janë lejuar sipas legjislacionit dhe/ose praktikës kombëtare dhe, në rastet kur është e zbatueshme, me kusht që autoriteti kompetent të ketë dhënë miratimin e tij.

2. Nëse një punëtorë, brenda kuptimit të nenit 2, pushohet nga puna gjatë periudhës të referuar në pikën 1, punëdhënësi duhet të sqarojë, mbi baza të argumentuara, pushimin e saj nga puna.

3. Shtetet anëtare do të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur punëtorët, brenda kuptimit të nenit 2, nga pasojat e pushimit nga puna, i cili sipas pikës 1 përbën një akt të paligjshëm.

### **Neni 11** **Të drejtat e punësimit**

Me qëllim për të garantuar punëtorëve, brenda kuptimit të nenit 2, ushtrimin e të drejtave për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së tyre, sikurse njihen nga ky nen, do të mundësohet që:

1. në rastet e referuara në nenet 5, 6 dhe 7, të drejtat e punësimit të lidhura me kontratat e punës, përfshirë këtu ruajtjen e pagesës dhe/ose të drejtën e një ndihme të mjaftueshme financiare për punëtorët, brenda kuptimit të nenit 2, duhet të sigurohen në përputhje me legjislacionin dhe /ose praktikën kombëtare;

2. në rastin e referuar në nenin 8, duhet të sigurohen si vijon:

a. të drejtat e lidhura me kontratën e punësimit të punëtoreve, brenda kuptimit të nenit 2, përveç atyre të referuara në pikën b më poshtë;

b. ruajtjen e një pagese dhe/ose të drejtën për një ndihmë të mjaftueshme financiare për punëtorët, brenda kuptimit të nenit 2;

3. ndihma financiare, referuar në pikën 2(b), do të gjykohet e mjaftueshme nëse garanton të ardhura të paktën ekuivalente me ato të cilat punëtorja në fjalë do të merrte në rast shkëputjeje prej aktiviteteve të saj për arsye që lidhen me gjendjen e saj shëndetësore, duke iu nënshtruar çdo kufiri maksimal të parashikuar nga legjislacioni kombëtar.

4. Shtetet anëtare mund të ofrojnë pagesën apo ndihmën financiare, referuar në pikat 1 dhe 2(b), me kusht që punëtorja në fjalë të përmbushë kushtet për këto përfitime në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Këto kushte nuk mundet, në asnjë rrethanë, të parashikojnë periudhat e punësimit të mëparshëm, menjëherë pas përfundimit të dymbëdhjetë muajve nga dita e lindjes së fëmijës.

## **Neni 12** **Mbrojtja e të drejtave**

Shtetet anëtare do të përfshijnë në sistemet e tyre ligjore kombëtare masa të tilla, për aq sa janë të nevojshme, për t'u mundësuar gjithë punëtoreve që e konsiderojnë veten padrejtësisht të prekur nga mos zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë, që të kërkojnë pretendimet e tyre nëpërmjet proceseve gjyqësore, dhe/ose, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare), mundësisht pas ankimit pranë autoriteteve të tjera kompetente

## **Neni 13** **Ndryshimet në Shtojca**

Rregullimet e sakta teknike në Shtojcën I, si rezultat i progresit teknik, ndryshimeve në rregulloret apo karakteristikat teknike ndërkombëtare dhe zbulimeve të reja në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë, duhen miratuar në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 17 të Direktivës 89/391/KEE.

Shtojca II mund të ndryshohet vetëm në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 118a të Traktatit.

## **Neni 14** **Dispozitat përfundimtare**

1. Shtetet anëtare do të miratojnë ligje, rregullore dhe dispozita administrative të nevojshme për përputhjen me këtë Direktivë, jo më vonë se dy vjet pas miratimit të saj ose të sigurojnë, jo më vonë se dy vjet pas miratimit të kësaj Direktive, se të dyja palët e industrisë do të paraqesin dispozitat e kërkuara nëpërmjet marrëveshjeve kolektive, me

shtetet anëtarë që iu kërkohet të hartojnë të gjitha dispozitat e nevojshme për të garantuar në çdo kohë rezultatet e parashikuara nga kjo Direktivë. Ato do të informojnë menjëherë Komisionin për këtë.

2. Kur shtetet anëtare miratojnë masat e referuara në paragrafin 1, ato do të përmbajnë një referencë të kësaj Direktive ose do të shoqërohen me një referencë të tillë në rast të publikimit zyrtar të tyre. Metodatat e hartimit të një reference të tillë, do të përcaktohen nga shtetet anëtare.

3. Shtetet anëtare do të dërgojnë pranë Komisionit tekstet e dispozitave bazë të legjislacionit kombëtar, të cilat ato i kanë miratuar tashmë apo miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo Direktivë.

4. Shtetet anëtare do t'i raportojnë Komisionit, çdo pesë vjet, mbi zbatimin praktik të dispozitave të kësaj Direktive, duke treguar në mënyrë të veçantë pikëpamjet e dy palëve të industrisë.

Megjithatë, shtetet anëtare do të raportojnë për herë të parë pranë Komisionit, mbi zbatimin praktik të dispozitave të kësaj Direktive, duke treguar në mënyrë të veçantë pikëpamjet e dy palëve të industrisë, katër vjet pas miratimit të saj.

Komisioni do të informojë Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin Këshillimor mbi Sigurinë, Higjienën dhe Mbrojtjen e Shëndetit në Punë.

5. Komisioni do të paraqesë, në mënyrë periodike, Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komitetit Ekonomik dhe Social, një raport mbi zbatimin e kësaj Direktive, duke marrë parasysh paragrafët 1, 2 dhe 3.

6. Këshilli do të rishqyrtojë këtë Direktivë, mbi bazën një vlerësimi të kryer nga raportet e referuara në nën paragrafin e dytë të paragrafit 4 dhe, nëse është e nevojshme, mbi bazën e një propozimi që paraqitet nga Komisioni të paktën pesë vjet pas miratimit të Direktivës.

## **Neni 15**

Kjo Direktivë i adresohet shteteve anëtare.

## **SHTOJCA I**

### **LISTA JO E PLOTË E AGJENTËVE, PROCESIVE DHE KUSHTEVE TË PUNËS, REFERUAR NË NENIN 4(1)**

A. Agjentët fizikë

1. Agjentët fizikë kur ata konsiderohen si agjentë që shkaktojnë dëmtime të fetusit dhe/ose ka gjasa se mund të prishin lidhjen placentale, dhe në veçanti:

- a. tronditja, dridhjet ose lëvizje;
- b. transportimi i ngarkesave që përbëjnë rrezik, sidomos kur mbahen mbi kurriz;
- c. zhurma;
- d. rrezatimi jonizues;
- e. rrezatimi jo-jonizues;
- f. ekstremet e të nxehtit dhe të ftohtit;
- g. lëvizjet dhe qëndrimet e trupit, lëvizjet, brenda ose jashtë ndërmarrjes, lodhja mendore dhe fizike dhe ngarkesa të tjera fizike të lidhura me aktivitetin e punëtore, brenda kuptimit të nenit 2 të kësaj Direktive.

### 2. Agjentët biologjikë

Agjentët biologjikë të grupeve 2, 3 dhe 4 të rrezikut, brenda kuptimit të nenit 2(d), numrat 2, 3 dhe 4 të kësaj Direktive 90/679/EEC, për aq kohë sa është e ditur se këto agjentë ose masat terapeutike të bëra të nevojshme nga këto agjentë, rrezikojnë shëndetin e gruas shtatzënë dhe fetusin dhe për aq kohë sa ato nuk përmbahen në Shtojcën II.

### 3. Agjentët kimikë

Agjentët kimikë të mëposhtëm për aq kohë sa janë të njohur për rrezikun që i shkaktojnë shëndetit të gruas shtatzënë dhe fetusit dhe për aq kohë sa ato nuk përmbahen në Shtojcën II.

- a. substancat me etiketë R 40, R 45, R 46 dhe R 47, sipas Direktivës 67/548/EEC , për aq kohë sa ato nuk përmbahen në Shtojcën II.
- b. agjentët kimikë në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC;
- c. mercuri dhe derivatet e tij;
- d. drogat antimitotike
- e. monoksidi i karbonit
- f. agjentët kimikë të njohur për absorbimin e rrezikshëm të tyre, nëpërmjet lëkurës

### B. Proceset

Proceset Industriale të listuar në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC.

### C. Kushtet e Punës

Puna nën tokë në minierë

## **SHTOJCA II**

### **LISTA JO E PLOTË E AGJENTËVE DHE KUSHTEVE TË PUNËS, REFERUAR NË NENIN 6**

#### **A. Punëtoret shtatzëna brenda kuptimit të nenit 2 (a)**

##### **1. Agjentët**

a. Agjentët fizikë

Puna në atmosferën hiperbarike, si për shembull, në zhytjet nën ujë apo në ambiente të mbyllura dhe nën presion

b. Agjentët biologjikë

Agjentët e mëposhtëm biologjikë:

- toksoplazma,

- virusi i rubeolës

vetëm në rast se punëtoret shtatzënë provohen se kanë një mbrojtje të mjaftueshme imunizuese ndaj këtyre agjentëve.

c. Agjentët kimikë

Plumbi dhe derivatet e tij, për aq kohë sa ato kanë aftësi të përthithen nga organizmi i njeriut.

2. Kushtet e punës

Puna nën tokë në minierë.